REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Has, me 20.05.2026

Relacion mbi: Raporti i monitorimit të buxhetit për Janar-Prill 2026.

Në mbështetje të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008,"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit Nr.87/2025, "Për Buxhetin e vitit 2026", ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit Nr.68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimit Nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit plotesues Nr.2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", si dhe VKB Nr.109 date 24.12.2025 , ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për Bashkinë Has, sipas programeve buxhetore të miratuara për vitin 2026.

1. Përshkrim i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit.

Ky raport ndihmon për monitorimin e zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, për produktet dhe objektivat e politikës të realizuara për çdo program. Monitorimi është një proçes vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performances me ato të planifikuar. Gjithashtu monitorimi është proçesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Programet e shpenzimeve monitorohen për të siguruar transparencë në lidhje me performancën e tyre.

2. Treguesit e monitorimit të përformancës duhet të jenë:

- *lehtësisht të kuptueshëm;*
- *specifikë e të lidhur ngushtë me qëllimin e politikës së programit dhe objektivat që synohen të arrihen përmes tij;*
- *lehtësisht të matshëm;*
- *të identifikueshëm.*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Bashkia Has gjatë Janar-Prill 2026, ka funksionuar me programe buxhetore si mëposhtë:

- Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi (01110)
- Sherbime policore (03140)
- Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojta civile (03280)
- Shërbime Bujqësore, inspektimi, ushqimi (04220)
- Menaxhimi I infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (04240)
- Administrimi I pyjeve dhe kullotave (04260)
- Rrjeti rrugor rural (04520)
- Menaxhimi I mbetjeve (05100)
- Planifikimi urban dhe vendor (06140)
- Shërbimet publike vendore (06260)
- Furnizimi me ujë (06370)
- Sport dhe argëtim (08130)
- Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore (08220)
- Arsimi bazë, përfshirë arsimin parashkollor (09120)
- Arsimi I mesëm I përgjithshëm (09230)
- Kujdesi social për familjet dhe fëmijët (10430)
- Strehimi social (10661+06190)
- Gjendja Civile (01170)
- Transferta qendrore per emergjenva civile (10910)

3. Tabelat e raportit të monitorimit.

Buxheti I Bashkisë Has mbështetet në burimet e financimit si mëposhtë:

I – Transferta e pakushtëzuar e planifikuar për vitin 2026

II- Të ardhurat vendore të planifikuara për vitin 2026

III- Transferta specifike e planifikuar për vitin 2026

IV- Transferta GR 00 sipas akt-trashëgimisë 2026

V- Të ardhurat vendore GR 05 sipas akt-trashëgimisë 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

3.1 Transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale për bashkinë Has për Janar-Prill 2026.

Fondi I akorduar sipas ligjit të buxhetit për vitin 2026 sipas tabelës:

Rrethi	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2025	Transferta e pakushtezuar dhe Transferta e pakushtëzuara sektoriale								Rritja e nivelit te pagave	**Totali**
		Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor		Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Admin is. i pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe Kullimi	Mbrojtja civile	
			Personel mësimor	Për stafin mbështetës							
Has	210,976,259	7,653,685	55,109,690	5,471,888	4,672,908	23,729,168	20,896,692	2,095,087	13,965,799	-	33,948,859	**378,520,035**

Në zbatim të Ligjit Nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", është miratuar buxheti për Bashkinë Has me VKB Nr. 109, date 24.12.2025 "Buxheti I Bashkisë Has për vitin 2026" dhe është verifikuar nga Prefektura e Qarkut Kukës me Nr.1/3, date 13.01.2026.

3.2 Shpërndarja e buxhetit sipas programeve,për Janar-Prill 2026.

Nr	Programi Buxhetor	Kodi	Buxheti I Programuar
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	01110	93,374,800
2	Shërbimet e Policisë Vendore	03140	7,923,180
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	36,207,388
4	Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi	04220	8,511,372
5	Menaxhimi i Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit	04240	18,754,305
6	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	04260	22,758,324
7	Rrjeti rrugor rural	04520	70,973,056
8	Menaxhimi i Mbetjeve	05100	13,554,528
9	Planifikimi Urban dhe Vendor	06140	4,891,560
10	Shërbimet publike vendore	06260	46,645,440
11	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	06370	77,028,020
12	Sport dhe argëtim	08130	6,965,120
13	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	08220	8,018,880
14	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	09120	112,552,526
15	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	09230	21,253,761
16	Përkujdesi social	10430	121,789,224
17	Strehimi Social	10661	300,000
18	Emergjenca civile	10910	19,408,164
19	Gjendja civile	01170	3,633,000
Totali Buxheti 2026			**694,542,648**

3.3 Tabela e raportit të shpenzimeve sipas programeve për Janar-Prill 2026.

Nr	Emërtimi i Programeve		Kodi	Plan për 4-mujori parë 2026	%	Fakt për 4-mujori I parë 2026	%	Realizimi në %
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	00	01110	93,374,800	13.4%	22,931,191	10.69%	24.56%
2	Shërbimet e Policisë Vendore	00	03140	7,923,180	1.1%	2,074,925	1%	26.19%
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	00	03280	36,207,388	5.2%	10,390,007	5%	28.70%
4	Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi	00	04220	8,511,372	1.2%	2,961,814	1%	34.80%
5	Menaxhimi i Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit	00	04240	18,754,305	2.7%	3,084,608	1%	16.45%
6	Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave	00	04260	22,758,324	3.3%	7,997,306	0	35.14%
7	Rrjeti rrugor rural	00	04520	70,973,056	10.2%	24,094,798	11%	33.95%
8	Menaxhimi I Mbetjeve	00	05100	13,554,528	2.0%	4,274,768	2%	31.54%
9	Planifikimi Urban dhe Vendor	00	06140	4,891,560	0.7%	1,429,713	1%	29.23%
10	Shërbimet publike vendore	00	06260	46,645,440	6.7%	14,591,408	7%	31.28%
11	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	00	06370	5,951,845	0.9%	2,097,615	1%	35.24%
12	Sport dhe argëtim	00	08130	6,965,120	1.0%	2,138,935	1%	30.71%
13	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	00	08220	8,018,880	1.2%	2,325,700	1%	29.00%
14	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	00	09120	63,947,766	9.2%	19,000,426	9%	29.71%
15	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	00	09230	21,253,761	3.1%	5,456,788	3%	25.67%
16	Përkujdesi social	00	10430	22,713,620	3.3%	5,060,453	2%	22.28%
17	Strehimi Social (Qendror)	00	10661	300,000	0.0%	-	0%	0.00%
18	Emergjenca civile	00	10910	68,040	0.0%	-	0%	0.00%
19	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	06	06370	71,076,175	10.2%	-	0%	0.00%
20	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollorin	11	09120	48,604,760	7.0%	-	0%	0.00%
21	Përkujdesi social	13	10430	99,075,604	14.3%	83,007,668	39%	83.78%
22	Gjendja civile	16	01170	3,633,000	0.5%	1,676,910	1%	46.16%
23	Emergjenca civile	17	10910	19,340,124	2.8%	-	0%	0.00%
	TOTALI			**694,542,648**		**214,595,033**		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

3.4 Tabela e raportit të shpenzimeve sipas artikujve buxhetore Fakti për Janar-Prill 2026.

		Fakt për 4-mujorin e parë 2026					
Nr	**Emërtimi i Programeve**	**Grupi**	**Kodi**	**Shpenzime Personeli (600-601)**	**Shpenzime të tjera korrente (602-606)**	**Shpenzime për Investime (230+231)**	**Totali**
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	00	01110	18,193,852	4,737,339		22,931,191
2	Shërbimet e Policisë Vendore	00	03140	2,074,925			2,074,925
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	00	03280	8,314,425	2,075,582		10,390,007
4	Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi	00	04220	2,961,814			2,961,814
5	Menaxhimi i Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit	00	04240	2,554,785	529,823		3,084,608
6	Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave	00	04260	7,839,306	158,000		7,997,306
7	Rrjeti rrugor rural	00	04520	8,732,461	5,000	15,357,337	24,094,798
8	Menaxhimi I Mbetjeve	00	05100	3,874,768	400,000		4,274,768
9	Planifikimi Urban dhe Vendor	00	06140	1,423,713	6,000		1,429,713
10	Shërbimet publike vendore	00	06260	13,591,408	1,000,000		14,591,408
11	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	00	06370	1,703,060	394,555		2,097,615
12	Sport dhe argëtim	00	08130	2,138,935			2,138,935
13	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	00	08220	2,207,700	118,000		2,325,700
14	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	00	09120	18,627,613	372,813		19,000,426
15	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	00	09230	5,225,005	231,783		5,456,788
16	Përkujdesi social	00	10430	3,841,523	1,218,930		5,060,453
17	Përkujdesi social	13	10430		83,007,668		83,007,668
18	Gjendja civile	16	01170	1,676,910			1,676,910
	TOTALI			**104,982,203**	**94,255,493**	**15,357,337**	**214,595,033**

Në realizimin e shpenzimeve të Fakti për Janar-Prill 2026, peshat specifike sipas artikujve buxhetore:

- shpenzimet për personelin në masën **49%**
- shpenzimet korrente **44%**
- shpenzimet kapitale në masën **7%.**



3.5 Tabela e raportit të shpenzimeve sipas artikujve buxhetore Plan për Janar-Prill 2026.

				Plani për 4-mujorin e parë 2026			
Nr	Emertimi i programit	Grupi	Kodi	Shpenzime Personeli (600-601)	Shpenzime të tjera korrente (602-606)	Shpenzime për Investime (230+231)	Totali
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	00	01110	66,888,636	24,886,164	1,600,000	93,374,800
2	Shërbimet e Policisë Vendore	00	03140	6,873,180	250,000	800,000	7,923,180
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	00	03280	24,275,388	11,932,000		36,207,388
4	Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi	00	04220	8,481,372	30,000		8,511,372
5	Menaxhimi i Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit	00	04240	7,095,264	11,659,041		18,754,305
6	Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave	00	04260	21,846,324	912,000		22,758,324
7	Rrjeti rrugor rural	00	04520	27,074,318	2,624,800	41,273,938	70,973,056
8	Menaxhimi I Mbetjeve	00	05100	11,934,136	1,620,392		13,554,528
9	Planifikimi Urban dhe Vendor	00	06140	4,326,960	450,000	114,600	4,891,560
10	Shërbimet publike vendore	00	06260	36,037,840	5,867,600	4,740,000	46,645,440
11	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	00	06370	4,318,836	1,406,000	227,009	5,951,845
12	Sport dhe argëtim	00	08130	6,315,120	650,000		6,965,120
13	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	00	08220	6,818,880	1,200,000		8,018,880
14	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	00	09120	56,488,140	6,598,438	861,188	63,947,766
15	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	00	09230	14,066,616	6,182,822	1,004,323	21,253,761
16	Përkujdesi social	00	10430	15,384,896	2,910,000	4,418,724	22,713,620
17	Strehimi Social	00	10661		300,000		300,000
18	Emergjenca civile	00	10910			68,040	68,040
19	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	06	06370			71,076,175	71,076,175
20	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollorin	11	09120		922,320	47,682,440	48,604,760
22	Përkujdesi social	13	10430		99,075,604		99,075,604
23	Gjendja civile	16	01170	3,633,000			3,633,000
24	Emergjenca civile	17	10910		9,670,062	9,670,062	19,340,124
	TOTALI			**321,858,906**	**189,147,243**	**183,536,499**	**694,542,648**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Në realizimin e shpenzimeve të Planit për Janar-Prill 2026, peshat specifike sipas artikujve buxhetore:

- shpenzimet për personelin në masën **46%**
- shpenzimet korrente **27%**
- shpenzimet kapitale në masën **26%.**

4) Monitorimi I shpenzimeve sipas programeve:

4.1 Planifikim, menaxhim dhe administrim:

Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë Has dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për mbarëvajtjen e punës në përmbushjen e funksioneve të përcaktuara në legjislacion.

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Bashkisë, të zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.

1.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore është si më poshtë:

Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	66,888,636	72%	18,193,852	79%	27.2%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	24,886,164	27%	4,737,339	21%	0.0%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	1,600,000	2%	-	-	0.0%
TOTALI		**93,374,800**	**100%**	**22,931,191**	**1**	**24.6%**

Buxhetimi për Funksionin "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has 2026 në mbështetje me fonde në total **93,374,800** lekë dhe për Janar-Prill 2026, janë shpenzuar **22,931,191** lekë ose **24.6** % në raport me fondin e planifikuar.

4.2 Shërbimet policore

Në këtë program buxhetor, bashkia planifikon shpenzime buxhetore të nevojshme për sigurimin e mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike në territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe ekzekutimin dhe zbatimin e akteve të tjera të nxjerra nga Kryetar I Njësisë dhe vendimet e Këshillit të Njësisë.

2.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Shërbimet e Policisë Vendore						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	6,873,180	87%	2,074,925	100%	30.2%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	250,000	3%	-	0%	0.0%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	800,000	10%	-	-	0.0%
TOTALI		**7,923,180**	**100%**	**2,074,925**	**1**	**26.2%**

Buxhetimi për Funksionin "Shërbimet Policore" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **7,923,180** Lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **2,074,925** lekë ose **26.2**% në raport me fondin e planifikuar.

4.3 Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Politika e këtij program konsiston në mbështetjen dhe asistimin me punonjës të PMNZSH-së të Bashkisë në rastet e fatkeqësive natyrore apo raste të dëmtimeve nga zjarri.

3.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	24,275,388	67%	8,314,425	80.0%	34.3%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	11,932,000	33%	2,075,582	20.0%	17.4%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**36,207,388**	**100%**	**10,390,007**	**1**	**28.7%**

Buxhetimi për Funksionin "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile" hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **36,207,388** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **10,390, 007** lekë ose **28.7** % në raport me fondin e planifikuar.

4.4 Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi

Në këtë program buxhetor, bashkia planifikon shpenzimet për administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore dhe mbështet shërbimet e blegtorisë. Bashkia administron shërbimet e peshkimit dhe gjuetisë, krijon dhe administron skema për grantet bujqësore dhe zhvillimin rural, si dhe ushtron kontrolle ushqimore me qëllim mbrojtjen e konsumatorit. Bashkia merr masat për ngritjen, plotësimin, ruajtjen dhe përditësimin e një sistemi informacioni mbi bazë parcele për 9im ë bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave.

4.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Shërbimet Bujqësore, inspektimi,ushqimi						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	8,481,372	100%	2,961,814	100.0%	34.9%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	30,000	0%	-	0.0%	0.0%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**8,511,372**	**100%**	**2,961,814**	**1**	**34.8%**

Buxhetimi për Funksionin "Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi ..." është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetjen me fonde në total **8,511,372** lekë dhe për Janar-Prill janë shpenzuar **2,961,814** lekë ose **34.8** % në raport me fondin e planifikuar.

4.5 Menaxhimi I Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Në këtë program buxhetor bashkia planfikon shpenzime buxhetore për ndërtimin ose organizimin e sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

5. Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Menaxhimi i Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit						
Artikulli	Emwrtimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli (600-601)	7,095,264	38%	2,554,785	83%	36.0%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	11,659,041	62%	529,823	17%	4.5%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	0%	0.0%
TOTALI		**18,754,305**	**100%**	**3,084,608**	**1**	**16.4%**

Buxhetimi për Funksionin "Menaxhimi I Infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **18,754,305** lekë dhe për Janar-Prill 2026, janë shpenzuar **3,084,608** lekë ose **16.4**% në raport me fondin e planifikuar.

4.6 Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave

Programi I administrimit të pyjeve synon administrimin e fondit pyjor kullosor sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu ky program ka për qëllim zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, pasuri kombëtare me rëndësi të veçanta, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës dhe tokës. Politika e programit përfaqëson synimet, prioritetet dhe drejtimet kryesore për zhvillimin afatgjatë e të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave.

6. Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	21,846,324	96%	7,839,306	98.0%	35.9%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	912,000	4%	158,000	2.0%	17.3%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**22,758,324**	**100%**	**7,997,306**	**1**	**35.1%**

Buxhetimi për Funksionin "Administrimi I pyjeve dhe Kullotave" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **22,758,324** lekë dhe për Janar-Prill 2026, janë shpenzuar **7,997,306** leke ose **35.1**% në raport me fondin e planifikuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

4.7 Rrjeti rrugor rural

Programi I menaxhimit rrugor, synon investime në infrastrukturën rrugore, përmirësimi I transportit dhe implementimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për zhvillimin e territorit. Synimi është zhvillimi I një qyteti të qëndrueshëm me cilësi të mirë jetese për banorët e tij si dhe ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimi rrugor, I trotuareve dhe shesheve publike vendore.

7. Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Rrjeti rrugor rural						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	27,074,318	38%	8,732,461	36%	32.3%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	2,624,800	4%	5,000	0%	0.2%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	41,273,938	58%	15,357,337	64%	0.0%
TOTALI		**70,973,056**	**100%**	**24,094,798**	**1**	**33.9%**

Buxhetimi për Funksionin "Rrjeti Rrugor Rural" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **70,973,056** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **24,094,798** lekë ose **33.9%** në raport me fondin e planifikuar.

4.8 Menaxhimi I Mbetjeve

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për ndërtimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe inspetimin e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve, si dhe fondet e nevojshme për pastrimin e rrugëve, parqeve etj.

8. Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Menaxhimi i Mbetjeve						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	11,934,136	88%	3,874,768	90.6%	32.5%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	1,620,392	12%	400,000	9.4%	24.7%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	0.0%	#DIV/0!
TOTALI		**13,554,528**	**100%**	**4,274,768**	**1**	**31.5%**

Buxhetimi për Funksionin "Menaxhimi i Mbetjeve" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetjen me fonde në total **13,554,528** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **4,274,768** lekë ose **31.5%** në raport me fondin e planifikuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

4.9 Planifikimi Urban dhe Vendor

Në këtë program buxhetor, bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim të planeve të zhvillimit urbanistik.

9.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Planifikimi Urban dhe Vendor						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	4,326,960	88%	1,423,713	99.6%	32.9%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	450,000	9%	6,000	0.4%	1.3%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	114,600	2%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**4,891,560**	**100%**	**1,429,713**	**1**	**29.2%**

Buxhetimi për Funksionin "Planifikimi Urban dhe Vendor" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **4,891,560** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **1,429,713** lekë ose **29.2**% në raport me fondin e planifikuar.

4.10 Shërbimet publike vendore

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike vendore, hapësirave publike dhe të gjelbërta, mirëmbajtjen e trotuareve, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe shërbime të tjera sipas nevojave dhe specifikave të njësisë.

10. Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Shërbimet publike vendore						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	36,037,840	77%	13,591,408	93.1%	37.7%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	5,867,600	13%	1,000,000	6.9%	17.0%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	4,740,000	10%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**46,645,440**	**100%**	**14,591,408**	**1**	**31.3%**

Buxhetimi për Funksionin "Sherbimet Publike dhe Vendore" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **46,645,440** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **14,591,408** lekë ose **31.3**% në raport me fondin e planifikuar.

4.11 Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për ndërtimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe organizimin e sistemeve të furnizimit me uje me qellim plotësimin e nevojave të vazhdueshme te komunitetit.

11. Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	4,318,836	73%	1,703,060	81.2%	39.4%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	1,406,000	24%	394,555	18.8%	28.1%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	227,009	4%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**5,951,845**	**100%**	**2,097,615**	**1**	**35.2%**

Buxhetimi për Funksionin "Furnizimi me Ujë" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetjen me fonde në total **5,951,845** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **2,097,615** lekë ose **35.2** % në raport me fondin e planifikuar.

4.12 Sport dhe argëtim

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për organizimin e aktiviteteve sportive çlodhëse e argëtuese zhvillimin dhe administrimin e objekteve. Politika e këtij programi synon nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës sportive në qytet, nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

12.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Sport dhe argëtim						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	6,315,120	91%	2,138,935	100.0%	33.9%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	650,000	9%	-	0.0%	0.0%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**6,965,120**	**100%**	**2,138,935**	**1**	**30.7%**

Buxhetimi për Funksionin "Sport dhe Argëtim" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **6,965,120** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **2,138,925** lekë ose **30.7** % në raport me fondin e planifikuar.

4.13 Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Programi I kulturës do të japë një hapësirë më të plotë jetës artistike dhe kulturore, jo vetëm duke u mbështetur në rivitalizmin e mëtejshëm të projekteve ekzistuese, të cilat janë kthyer tashmë në një traditë, por edhe duke dhënë hapësira të reja për projekte të tjera inovative. Politika e këtij programi synon krijimin e një jete sa më të pasur kulturore dhe sociale.

13.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	6,818,880	85%	2,207,700	94.9%	32.4%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	1,200,000	15%	118,000	5.1%	9.8%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**8,018,880**	**100%**	**2,325,700**	**1**	**29.0%**

Buxhetimi për Funksionin "Trashëgimia Kulturore, Eventet artistike dhe Kulturore" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **8,018,880** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **2,325,700** lekë ose **29.0%** në raport me fondin e planifikuar.



4.14 Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Programi I arsimit parashikon veprimtarinë ekonomike-financiare dhe atë të shërbimit në arsimin parashkollor, duke krijuar kushte sa më optimale për arsimin parashkollor, si dhe duke përdorur burimet financiare në mënyrë efiçente, efektive dhe ekonomike.

14.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	56,488,140	88%	18,627,613	98.0%	33.0%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	6,598,438	10%	372,813	2.0%	5.7%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	861,188	1%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**63,947,766**	**100%**	**19,000,426**	**1**	**29.7%**

Buxhetimi për Funksionin "Arsimi parashkollor, Arsimi 9-Vjecare dhe Punonjësit Ndihmës" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **63,947,766** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **19,000,426** lekë ose **29.7** % në raport me fondin e planifikuar.

4.15 Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

Programi i arsimit të mesëm të përgjithshëm parashikon veprimtarinë ekonomike-financiare dhe atë të shërbimit në arsimin parauniversitar si dhe konviktet e arsimit parauniversitar, duke krijuar kushte sa më optimale të mësimnxënies si dhe duke përdorur burimet financiare në mënyrë efiçente dhe efektive.

15.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	14,066,616	66%	5,225,005	95.8%	37.1%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	6,182,822	29%	231,783	4.2%	3.7%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	1,004,323	5%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**21,253,761**	**100%**	**5,456,788**	**1**	**25.7%**

Buxhetimi për Funksionin "Konvikti Kosova Krumë dhe punonjës mbështetës Arsimi Parauniversitare" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **21,253,761** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **5,456,788** lekë ose **25.7** % në raport me fondin e planifikuar.

4.16 Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Ky program synon të përmbushet përmes zhvillimit të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, ndërtimit të shërbimeve të reja dhe shpërndarjes së tyre sa më pranë qytetarëve, sipas modeleve të praktikave të mira bashkëkohore.Fokusi është trajtimi I familjeve në nevojë,ndërtimi dhe administrimi I qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore,bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale për financimin e shërbimeve,zbutja e problemit të varfërisë dhe strehimit për familjet me të ardhura të mesme dhe të uleta.

16. Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Përkujdesi social						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	15,384,896	68%	3,841,523	75.9%	25.0%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	2,910,000	13%	1,218,930	24.1%	41.9%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	4,418,724	19%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**22,713,620**	**100%**	**5,060,453**	**1**	**22.3%**

Buxhetimi për Funksionin "Kujdesi Social për familjet dhe fëmijët" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **22,713,620** lekë dhe për Janar-Prill 2026 janë shpenzuar **5,060,453** lekë ose **22.3%** në raport me fondin e planifikuar.

4.17Strehimi Social

Ky program synon administrimin dhe planifikimin e programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.

17. Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Strehimi Social						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	-	0%	-	#DIV/0!	0.0%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	300,000	100%	-	#DIV/0!	0.0%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	#DIV/0!	0.0%
TOTALI		**300,000**	**100%**	**-**	**#DIV/0!**	**0.0%**

Buxhetimi për Funksionin "Strehimi Social" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **300,000** lekë dhe për Janar-Prill 2026 nuk kemi shpenzime në raport me fondin e planifikuar.

4.18 Emergjenca Civile

Ky program synon permiresimin një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake ,të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.

18. Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Emergjenca Civile						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	-	0%	-	#DIV/0!	#DIV/0!
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	-	0%	-	#DIV/0!	#DIV/0!
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	68,040	100%	-	#DIV/0!	0.0%
TOTALI		**68,040**	**100%**	-	**#DIV/0!**	**0.0%**

Buxhetimi për Funksionin "Emergjenca Civile" është hartuar në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2026 në mbështetje me fonde në total **68,040** lekë dhe për Janar-Prill 2026 nuk kemi shpenzime në raport me fondin e planifikuar.

5 Transfertat e kushtezuara.

5.1 Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime

Në këtë program buxhetor bashkia planifikon shpenzimet buxhetore për ndërtimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe organizimin e sistemeve të furnizimit me uje me qellim plotësimin e nevojave të vazhdueshme te komunitetit.

1.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	-	0%	-	#DIV/0!	#DIV/0!
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	-	0%	-	#DIV/0!	#DIV/0!
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	71,076,175	100%	-	#DIV/0!	0.0%
TOTALI		**71,076,175**	**100%**	-	**#DIV/0!**	**0.0%**

Buxhetimi për Funksionin **"Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime"** është shtuar në buxhetin e Bashkisë Has, sipas shkresë Nr.1654 datë 22.04.2026 nga Ministria e Infrstrukturs dhe Energjisë , ku për vitin 2026 ka një mbështetje me fonde në total **71,076,175** lekë dhe për Janar-Prill nuk janë shpenzuar fondet që janë në dispozicion .

5.2 Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.

Programi I arsimit parashikon veprimtarinë ekonomike-financiare dhe atë të shërbimit në arsimin parashkollor, duke krijuar kushte sa më optimale për arsimin parashkollor, si dhe duke përdorur burimet financiare në mënyrë efiçente, efektive dhe ekonomike.

2.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	-	0%	-	#DIV/0!	#DIV/0!
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	922,320	2%	-	#DIV/0!	0.0%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	47,682,440	98%	-	#DIV/0!	0.0%
TOTALI		**48,604,760**	**100%**	-	**#DIV/0!**	**0.0%**

Buxheti për **"Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor"** si transfertë e kushtëzuar për Bashkinë Has, sipas shkresës Nr.469/1 datë 23.01.2026 dhe shkresa 2720 datë 08.04.2026, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në total për vitin 2026 janë akorduar **48,604,760** lekë ndërsa për Janar-Prill 2026 nuk jan shpenzuar fondet e disponushme.

5.3 Përkujdesi social

Ky program synon të përmbushet përmes zhvillimit të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, ndërtimit të shërbimeve të reja dhe shpërndarjes së tyre sa më pranë qytetarëve, sipas modeleve të praktikave të mira bashkëkohore.Fokusi është trajtimi I familjeve në nevojë,ndërtimi dhe administrimi I qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore,bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale për financimin e shërbimeve,zbutja e problemit të varfërisë dhe strehimit për familjet me të ardhura të mesme dhe të uleta.

3.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Përkujdesi social						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	-	0%	-	0.0%	#DIV/0!
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	99,075,604	100%	83,007,668	100.0%	83.8%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**99,075,604**	**100%**	**83,007,668**	**1**	**83.8%**

Buxheti për **"Përkujdesi social"** si transfertë e kushtëzuar për Bashkinë Has sipas shkresave perkatëse për Ndihmen Ekonomike,Pak dhe Fondin Social shkresa Nr.66/2 date 12.03.2026, 24/2 date 29.01.2026,975/1 datë 10.02.2026, në total për vitin 2026 janë akorduar **99,075,604** lekë ndërsa është përdorur për për Janar-Prill 2026 shuma prej **83,007,668** lekë ose **83.8**% në raport me fondin e ardhur.

5.4 Gjendja Civile

Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson, përditëson dhe administron Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Gjendja Civile						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	3,633,000	100%	1,676,910	100.0%	46.2%
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	-	0%	-	0.0%	#DIV/0!
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	-	0%	-	0.0%	0.0%
TOTALI		**3,633,000**	**100%**	**1,676,910**	**1**	**46.2%**

Buxhetimi për Funksionin **"Gjendja Civile"** është shtuar në buxhetin e Bashkisë Has, sipas shkresë Nr.6466/12 datë 23.01.2026, ku për vitin 2026 ka një mbështetje me fonde në total **3,633,000** lekë dhe në periudhen per Janar-Prill 2026 janë realizuar **1,676,910** lekë ose **46.2**% në raport me fondin e ardhur për vitin 2026.

5.5 Emergjenca Civile

Ky program synon permiresimin një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake ,të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.

5.Tabela e raportit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore si më poshtë:

Emergjenca Civile						
Artikulli	Emertimi	Plani 4-mujori i parë 2026	%	Fakti 4-mujori i parë 2026	%	Realizimi ne %
600-601	Shpenzime Personeli(600-601)	-	0%	-	#DIV/0!	#DIV/0!
602-606	Shpenzime te tjera korrente (602-606)	9,670,062	50%	-	#DIV/0!	0.0%
230-231	Shpenzime për Investime (230+231)	9,670,062	50%	-	#DIV/0!	0.0%
TOTALI		**19,340,124**	**100%**	**-**	**#DIV/0!**	**0.0%**

Buxhetimi për Funksionin **"Emergjenca Civile"**është shtuar në buxhetin e Bashkisë Has, sipas shkresa 429/6 datë 15.01.2026, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku për vitin 2026 ka një mbështetje me fonde në total **19,340,124** lekë dhe në periudhen Janar-Prill 2026 nuk janë realizuar fondet e ardhur për vitin 2026.

6. Tabela e shperndarjes së detyrimeve te prapambetura për vitin 2026.

Nr	Emërtimi	Detyrimi	Furnitori	Burimet e Financimit
1	Kolaudim punimesh rruga Zahrishtit	28,200	Xh & Miller Shpk	Buxhet Bashkisë
2	Ndërtim ujësjellësi Krumë Zahrisht vazhdim Shtesa	163,409	Lala Shpk	Buxhet Qeverisë Qëndrore
3	Rikonstruksion Gjimnazi Skenderbue Krume	3,513,396	T&J Construction	Buxhet Qeverisë Qëndrore
TOTALI		**3,705,005**		